



Titulli i projektit

Casa familia

Tipi i projektit

Projekte që mobilizohen shpejt

Vendndodhja e projektit

Shijak dhe Xhafzotaj

Buxheti i paravlerësuar

200,000 euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Nga analiza e Zonës Funksionale Shijak, tek seksioni i shërbimeve sociale të ofruara në zonë, rezulton se në të gjitha NJQV e marra së bashku, banojnë mbi 1400 persona me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, nga tabela e qendrave shëndetësore në shërbim të popullsisë, nuk rezulton asnjë institucion që mbulon këtë sektor. Prandaj lind nevoja që përvojat pozitive në disa bashki të tjera me krijimin e Casa Familia dhe ofrimin e shërbimeve në ndihmë të personave me aftësi të kufizuara, të replikohen edhe në Zonën Funksionale Shijak. Ky projekt do të ishte një shërbim i shtuar publik ndaj një grupi në nevojë të komunitetit vendas.

Qëllimi/et specifik të projektit

Qëllimi i projektit është ofrimi i shërbimeve të specializuara në ndihmë të personave me aftësi të kufizuara. Nëpërmjet këtij projekti do të arrihet të realizohet trajtim dhe kujdes i specializuar për këta persona, shërbim që ka munguar më përpara, në qendrën Casa familia.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Të gjitha NJQV e Zonës Funksionale Shijak do të përfitonin njëloj nga zbatimi i projektit. E gjithë popullsia e Zonës Funksionale e në veçanti personat me aftësi të kufizuara, mbi 1400 të tillë, janë përfituesit e këtij projekti. Niveli i shërbimeve publike në favor të komunitetit dhe në veçanti ndaj personave me nevojë të veçanta, do të përmirësohej ndjeshëm me krijimin e 2 qendrave Casa Familia.

PROJEKTI 9



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Aktivitetet kryesore të këtij projekti me kohëzgjatje 2-vjeçare janë:

- Identifikimi dhe rikonstruksioni i dy ambjenteve me sipërfaqe të bollshme në Shijak dhe Xhafzotaj, si dy NJQV me numrin më të madh të personave me aftësi të kufizuara;
- Pajisja e ambjenteve me mjetet e nevojshme për të ofruar shërbime të përshtatshme;
- Përzgjedhja e stafit të specializuar për shërbime të tilla;
- Rritja e kapaciteteve të stafit;
- Promovim dhe ndërgjegjësim i komunitetit, etj..

Maturimi i projektit

Ka vetëm një koncept të qartë për nevojën dhe mundësitë që do të ofronte zbatimi i këtij projekti. Për zbatimin e këtij projekti, hapi i parë që duhet të ndërmerret është marrëveshja me pushtetin vendor dhe shërbimin shëndetësor.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Duke marrë në konsideratë pamundësitë financiare të pushtetit vendor për financimin e projekteve të kësaj natyre, do të ishte e përshtatshme që të kërkohej financim nga donatorët e huaj dhe fondet e zhvillimit të rajoneve të Qeverisë Shqiptare. Institucionet e shërbimit shëndetësor, në partneritet me pushtetin vendor, do të ishin aktorët më të përshtatshëm për zbatimin e këtij projekti.

Kostot e projektit

Identifikimi dhe rikonstruksioni i dy ambjenteve me sipërfaqe të bollshme në Shijak dhe Xhafzotaj	50,000
Pajisja e ambjenteve me mjetet e nevojshme për të ofruar shërbime të përshtatshme	30,000
Rritja e kapaciteteve të stafit	3,000
Funksionimi çdo ditë i qendrës	100,000
Promovimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit	3,000